

# Koncepti simbolik dhe reflektet e sintezave të sensibilitetit dhe sensitivitetit në legjendën Rozafat

Nga Gjekë Marinaj

Nuk është aspak e lehtë t'i përcaktojmë të gjithë faktorët që kanë ndikuar në vendimin e Rozi Theoharit për të zgjedhur Rozafën si heroinën kryesore të librit të saj më të fundit.

Titulli i librit, i cili është plotësisht në harmoni me subjektin e veprës, është Rozafat. Konfidencën në probabilitetin e suksesit, përvoja dhe potenciali profesional i Theoharit të bindin se ajo ka qenë e ndërgjegjshme për vështirësitë me të cilat do të ndeshë gjatë orvajtjes së saj për të lëshuar një dritë të re konceptuale dhe etike mbi personalitetin e Rozafës, në raport me shoqërinë në të cilën ajo jetonte.

Për ta kuptuar me mirë mesazhin filozofik të autores, le t'u referohemi dy vargjeve të mëposhtme, ku kemi të bëjmë me një ton protestues poetik:

"Një vdekje pa varr"—i kuajve iso-trok

"Një vdekje pa varr"—i kuajve refren-trok (Theohari, 53)

"Kredinë" apo "fajin" kryesor për këto "fickla" të autores, në emër të saj edhe të Rozafës, njëkohësisht, mund t'u aq lemë refleksioneve të dyta—frimëzimit instinktiv që e vë krijuesin në lëvizje si rezultat i ngacmimit të brendshëm nga kontakti me diçka të jorëndomtë. Pasi lexon sakrificën e jashtëzakonshme të Rozafës, edhe Rozi vendos të sakrifikojë diçka nga vetja: shtresën e perceptimit të të tjerëve ndaj iniciativës së saj për të risuar njëri prej legjendave më të njohura dhe më të popullarizuara të arsenalit tonë legjendar. Ajo që në dukje të parë mund të identifikohet si dorëzim pa kushte i autores tek heroizmi i pashoq i Rozafës, e shohim të shëndrohet pa ndonjë vrazhdësi të dukshme tranzicionale në një kontroll të plotë të ideve të saj për modifikimin e legjendës.

Libri zgjon interes sidomos për konceptin simbolik si dhe për reflektet e sintezave të sensibilitetit dhe sensitivitetit që mbart në vetvete heroina kryesore pas së cilës është emëruar edhe vet legjenda. Natyrisht, që në vorbullën e re të rikrijimit janë mbështjellë huazime signifikante nga versionet trashëguar—nga gojëdhënat e lashta popullore. Kjo është realizuar duke ju përshtatur me përgjegjësi profesionale esencës së legjendës. Duke e bërë këtë, Theohari e distancoi veten nga dinamika e perceptimit të të tjerëve ndaj saj si dublikuese, në njëri anë, por edhe ndaj perceptimeve tradicionale të të tjerëve ndaj legjendës së Rozafës, në anën tjetër. Një veprim i tillë është i mençur, sepse sado i arrihtë të mbetej vështrimi i legjendës parë vetëm nga pozicioni mitologjik, ai do e linte lexuesin për të dëshnuar.

Ndoshta pikërisht për këtë arsye, Theohari është përqëndruar sidomos në aspektin psikologjik dhe social të legjendës. Aty vihen edhe disa shtresa të tjera të reja si pjesë të progresit analitik të legjendës. Është fjala për këndvështrimin femëror, injektimi i të cilit evidentualisht është përgjithësisht produkt i spontanitetit të

Theoharit. Në arsenalin poetik të Theoharit në këtë libër, brishtësisë dhe sensitivitetit femëror i bashkangjitet jo vetëm thellësia e mendimit, por edhe shpirti imagjinativo-poetik, prej te cilit kanë dalë edhe dy vargjet që vijojnë:

Llokoçitja e ujit tash jep formë njeriu

...Ajo ngriu... (Theohari, 63)

Në zanafillën e përpjekjeve për të rigjeneruar potencialin femëror të Rozafës, autorja transplanton tek ajo diçka nga personaliteti i saj autorial. Dëshira për t'i qendruar besnike subjektit të shprehës dhe të intonacioneve të ngrohta trashëguar nga gojëdhënat popullore ka rezultuar në një përpjesëtushmëri të drejtë përkundrajt energjisë së brendshme autoriale të Theoharit. Pikërisht në këtë pikë mund t'i gjejmë rrënjët e distributimit normal të emozioneve të saj, të cilat e kanë mbështjellë legjendën me rregullësinë që mbështjellin vijat e latitudes dhe altitudes globin tokësor—vija të holla përcaktuese, por gjithësesi imagjinuese. Le të përqendrohemi një moment në reshatat e parë dhe të dytë që pasojnë. Ato jepen si produkt popullor në krahasim me vargun e fundit që ngjitet ëmbëlsisht pas tyre si një etiketë stolisëse që përfaqëson eksklusivisht autoren:

Fal me shëndet ju o kodra, fusha

Drurët e ullirit, lule, pemë e ti o ngrinë e djenrë

Ku këmbët e mia po shkelin

Rozi Theohari nuk del aq hapur sa të shtrojë direkt pyetjet se: përse duhej murosur patjetër një grua; kur secili nga të tre vëllezërit i plotësonite kriteret e sugjeruara nga plaku, si kusht i domosdoshëm për qëndrimin lart të mureve të kalasë? Ajo nuk sfidon hapur as ligjet e të (pa)drejtës së një gruaje për të kundërshtuar murosjen e saj përsëgjalli.

për të fundit herë (Theohari 64)

Theohari në punën e saj demonstroi njohuri të plotë për mekanizmin letrar që e shtyn parpara imazhin e tragjedisë së Rozafës. Ajo ketë njohje e ve në shërbimin tonë si lexues dhe në shërbim të saj si autore. Puna e saj në librin Rozafat të bind se, duke shartuar idetë e saj në disa nga degët e pafrutëshme të legjendës, ajo vetëm i përtërin nociohet dhe elaboracionet bazë të Rozafës:

Kurthi, tek erdhi me këmbët e veta!

Përpëlitet në ethe nuse-shkre-ta,

Gojë e buzë tharë tërë maraz, Hovi i shpirtit ngritur në tal-laz (Theohari, 66)

Natyrisht, suksesi i një pune të tillë do të ishte një barrë tepër e rëndë për shpatullat e saj. Ndaj për këtë ajo kërkon ndihmë të psikologjia shqiptare e asaj kohe, kur është fjala për të vënë në zbatim ligjet e drejtpërdrejta të zberthimit shpirtëror dhe ndergjegjesimit me të cilin Rozafa e kryen aktin e murosjes. Në një univers të tillë human ndergjegjesimi i Rozafës paraqitet si akt në akord me kodet etike dhe me interpretimin e njëanshëm qytetar të asaj kohe, që në një mënyrë apo në një tjetër, i gjithë njerëzimi kishte një fare konjunkte të vetëdijshme për të.



Ballina e librit të Rozi Theoharit "Rozafat"

Jo. Rozi Theohari nuk del aq hapur sa të shtrojë direkt pyetjet se: përse duhej murosur patjetër një grua; kur secili nga të tre vëllezërit i plotësonite kriteret e sugjeruara nga plaku, si kusht i domosdoshëm për qëndrimin lart të mureve të kalasë? Ajo nuk sfidon hapur as ligjet e të

pretimit të autores qendron e pavarur nga reminishencat e rënditjes kronologjike, logjike, qoftë edhe gjeografike kundrejt ngjarjeve që zenë vend në versionin e legjendës së Rozafës tradicionale. Ne dimë se shumë shkrimtarë e kanë kërkuar me dedikim profesional konjuk-

(pa)drejtës së një gruaje për të kundërshtuar murosjen e saj përsëgjalli. Në kontrast, mënyra që Theohari ka përdorur për të shpjeguar kontrollin absolut të meshkujve ndaj femrave në kulturën shqiptare, i përket më tepër modelit të metabolës në mitologji, se sa natyrës historike që gjejmë tek epika jonë legjendare.

Transformimi poetik që gjejmë në trajtimin e problemeve me të mprehta shoqërore në lidhje me figurën e Rozafës, si bërthama kryesore e legjendës,

Në kontrast, mënyra që Theohari ka përdorur për të shpjeguar kontrollin absolut të meshkujve ndaj femrave në kulturën shqiptare, i përket më tepër modelit të metabolës në mitologji, se sa natyrës historike që gjejmë tek epika jonë legjendare.

reflekton një dritë të re mbi simbolizmin, imazhet, karakteret, ose edhe mbi mënyrën e te shkruarit që nuk janë domosdoshmërisht të ngjitur vetem te një kulture apo brez njerëzish. Nga lexuesi i sotëm duhet kuptuar se legjenda është rishkruar në mbështetje dhe jo kundra shoqërisë që e lexon atë.

Sigurisht që kjo nuk do të thotë se depertueshmëria nëpër degëzimet origjinale të inter-

turën e marrëdhënieve të legjendave dhe mitologjisë me shoqërinë që i ka sjellë deri në kohët moderne ato. As Theohari nuk tenton që të ndahet nga kjo lloj metode kërkimore. Ajo as që tenton të mohojë se Rozafa është pjesë e pandarë e një periudhe te caktuar kohore, e një shoqërie të caktuar, dhe se ajo nga vet natyra e sakrificës që bën është dhe mbetet produkt legjendar tipik i njeriut shqiptar:

Rozafat lind e përendon si dielli.

Ndërsa gurët vajojnë, ofshaj-një  
E nuk rreshtin së derdhurit lotë  
Gjoksi i lakuriqitë, i gurte, i bardhë  
Pikëzla qumështi pikon  
Varur si stalaktite gjithmonë (Theohari, 74).

Veçori të tilla e bëjnë botën krijuese të Theoharit unike. Moshezitimi për të reflektuar bindjet dhe orientimin shoqëror

të saj në raport me çështje të tilla etike dhe historike, tregon sinçeritet në marrëdhëniet që ajo dëshiron të mbajë me lexuesin shqiptar. Pavarësisht se heroizmi i Rozafës është trajtuar edhe nga autore të tjerë, veçanërisht nga Kadareja, Theohari është femra e parë, me aq sa di unë, që ka marrë guximin ta zhvendosë Rozafën nga podiumi i lashtësisë për ta vendosur atë në skenën bashkëkohore të gjykimit, ku Rozafa vetë bëhet gjykuete e heroizmit të vet, duke ua përcaktuar saktë diagnozën disa meshkujve që edhe sot vuajnë nga sëmundja e shovinizmit, në marrëdhëniet me femrat. Nëse nëpërmes vargjeve të librit Rozafat, Rozafa ecën me kahje të kundërta ndaj ndjenjës së vertete të saj, për të mos ua prishur burrave të shtëpisë, Rozi vendos të luajë rolin e interpreteses e pse jo edhe të avokates së saj në gjyqin shoqëror kundër të gjithë atyre që akoma manifestojnë me flamuj superioritetin ndaj femrës shqiptare e botërore, nga që libri jep edhe versionin në aglisht të legjendës.

Përqendrimi në elementin human të krijimit artistik është një plus në këtë libër. Aty shtjellohen në mënyrë ambivalente marrëdhëniet e humaneve me botën natyrale dhe pasojat e këtyre marrëdhënieve në kulturën tonë.

Theohari, e cila e një mirë kulturën e lashtë të vendit të saj, jep një kombinim të faktorëve imagjinative dhe studimorë pa i ngatërruar paralelet konceptuale të njëra-tjetres. Nëpërmes legjendës së Rozafës kuptojmë se legjenda shqiptare na ka lënë jo vetëm një trashëgimi të fuqishme dhe magjepsëse, por na fut në brendësinë e mënyrës se si njeriu i lashtë shqiptar provonte ta kuptonte vetveten dhe botën në të cilën ai jetonte.

Në vazhdim të asaj që thashë me lart, autorja, duke e veshur Rozafën me një petk të ri të instinkteve humane, ajo nuk e ngushton vizionin vetem te vetja, por e zgjeron atë duke nxjerrë në hapësirë ngjyrtat, shijet, ndjesitë dhe sentimentin e femrës moderne shqiptare. Ne jemi mësuar me Rozafën "burrërore" e cila e bën jeten fli pa shprehur fare shqetësim për fundin e jetës së saj. Me atë Rozafë që i vetmi shqetësim i zëshëm është

grua apo, sepse çdo kundërsh-tim do të ishte i kotë kur i shoqi dhe kunetërit e saj, i kishin bërë llogaritë në emër të saj. Kur them nuk e jep hapur, ndoshta duhet kuptuar se ajo e lë të hapur atë subjekt, me qëllim që lexuesi ta kuptojë pozicionin e saj si autore dhe po kështu të kujtojë se edhe shkrimtarët dhe poetët kanë të drejta të rezervuara kur është fjala e të pagëzuarit të mendimeve të tyre në fakte. Megjithatë, ajo mundohet ta vendosë veten sa më në qendër, midis të shpikurës dhe faktit.

Theohari përgjigjet me aq sa mendon se është e arsyeshme. Natyrisht duhet konsideruar se këtu ajo ballafaqohet edhe me një vështirësi tjetër. Dihet se legjenda dhe mitologjia shqiptare nga vet natyra e tyre janë të ndërlikuara. Por ato kanë mbijetuar në sajë të bukurisë aktive që mbartin në vetevete. Në këtë aspekt, logjikisht, libri mban karakter letrar e jo shkencor. Ndaj duhet cilësuar se në këtë libër Theohari bëhet vërtet vetëm një përcuese e kësaj energjie legjendare. Ky përcim, për fat të mirë, bëhet me një fuqi krejtësisht të re ndriçuese.

Së fundi, le të lexojmë vargjet e mëposhtme, të shkruara me qëllim e vetedije për të mbështetur idene kryesore të këtij shkrimi. Këtu autorja na paraqitet e këtuillë; emocionalisht e tejdrukshme dhe direkte, si në evaluimin e mendimeve të saj ashtu edhe në substancën e shprehjes së tyre:

Ajo bëret:  
"Ju lutem, Primi!"  
Por ata s'presin... rrëmbejnë trupin e saj  
Dhe e shtrijnë poshtë, mbi rrasa guri të zeza  
Duke punuar shpejt,  
Më shpejt se koha,  
Ndërsa ajo nxjerr një klith-më vajtuese  
Që shpon qiejt,  
Duke u mbrojtur sa mund me duar  
Kundrejt burrave zemërgur... (Theohari, 66).

Këto vargje do të mjaftonin për konkluzionin e kësaj eseje letrare. Sidoqoftë, desha të përsërisja edhe një herë që, në njëri anë, Rozi Theohari, me veprën e saj më të fundit, sjell pranë nesh një epokë të guditëshme e cila është krejtësisht e huaj për ne. Por në anën tjetër, ajo rishkruan një legjendë shumë të njohur, pyetjet rreth së cilës akoma nuk kanë gjetur përgjigje të plotë as në librin e Rozit as në librat e shkrimtarëve të tjerë. Prej tyre do të veçoja këto: Çfarë i bën njerëzit të shkojnë drejt situatave ekstreme sa të murosin një pjesëtar të familjes? Përse ne shqiptarët e duam lirinë dhe mundësinë për ta mbrojtur atë me kaq forcë dhe pasion? Ku, ekzaktësisht, gjendet vija që ndan dëshirën me detyrimin njerëzor për të kryer vetmohime të natyrës së Rozafës? Dhe, më tej, ishte fundi i jetës së Rozafës vetëmuri apo murim? Por arsyeja që Rozi Theohari jep vetëm mendimet e saj dhe jo fakte rreth këtyre pyetjeve është e thjeshtë: Ajo është Rozi dhe jo Rozafa.